

## Zbatimi i Konventës së Stambollit-garanci për mbrojtjen e fëmijëve nga dhuna e asistuar

M.B. është 41 vjeç, me arsim vetëm 10 klasë, e papunë, me dy fëmijë, ishte njohur me bashkëshortin e saj në moshën 15 vjeç. Bashkëshorti konsumues i alkoolit e keqtrajtonte, nuk e vlerësonte, e nënvleftësonte dhe e poshtëronte, duke ushtruar dhunë sistematike ndaj saj. Denoncimi i parë i dhunës u krye nga M.B. në vitin 2017, pasi situata ishte tejet kritike. Bashkëshorti, tashme i degraduar nga alkooli, nisi të merrte leke nga kursimet e shtëpisë, ndërkohë që të gjithë rrogën e tij e prishte pa sjellë asgjë për fëmijët. Sikur të mos mjaftonin të gjitha këto, në shtëpinë e tyre filluan të prezantoheshin borxhlinjtë dhe shpeshherë M.B., detyrohej të punonte në dy punë për të larë borxhet e bashkëshortit.

M.B. e kishte falur disa herë bashkëshortin për hir të fëmijëve, me shpresën se ai ishte penduar, se do të ndryshonte dhe do të reflektonte në dobi të familjes. Por më kot, çdo përpjekje e saj për të ndryshuar situatën merrte si përgjigje prej tij aludime tradhtie, ofendime dhe kërcënime të vazhdueshme.

M.B. e vetëdijshme që situata po përkeqësohej jo vetëm ndaj saj, por edhe ndaj djalit të mitur, i cili njohu të gjitha format e dhunës nga i ati, fizike, psikologjike seksuale, ekonomike, iu drejtua organeve përkatëse me mbështetjen e avokateve të Qendrës për Nisma Ligjore Qytetare, Av. Etleva Zeqiraj dhe Av. Andia Dragoj.

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, ka lëshuar Urdhër Mbrojtjeje për M.B., në vitin 2018, kurse në vitin 2019 Gjykata lëshoi një tjetër urdhër mbrojtje duke vënë në mbrojtje M.B., si dhe fëmijën e tyre të mitur.

Aktualisht, Gjykata e Rrethit Gjyqësor, Tiranë, vendosi zgjidhjen e martesës dhe "... lënien e fëmijës së mitur për rritje dhe edukim të mbijetuarës nga dhuna në familje, nënës së fëmijëve M.B., detyrimin e bashkëshortit dhunues, palë e paditur të kontribuojë në rritjen dhe edukimin e fëmijës së mitur nga dita e ngritjes së kërkesë padisë në shumën 10.000 (dhjetë mijë) lek si edhe takime vetëm për dy orë të fëmijës së mitur me të atin, pa fjetje".

Qëndrimi i Gjykatës është në përputhje me interesin më të lartë të fëmijëve dhe konventat e ratifikuara nga shteti shqiptar, veçanërisht Konventën e OKB-së "Mbi të drejtat e Fëmijëve" dhe Konventën e Këshillit të Evropës "Për parandalimin dhe luftimin kundër dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje (Konventa e Stambollit)". Kjo e fundit, në nenin 31 të saj, sanksionon: **"Kujdestaria, të drejtat e vizitave dhe siguria"** kërkon nga **shtetet Palë të marrin masat e nevojshme legjislative ose masa të tjera për të garantuar që, në përcaktimin e kujdestarisë dhe të drejtave të vizitave të fëmijëve, të merren në konsideratë incidentet e dhunës.**

Vecoritë e rastit dhe nevoja për ta ndjekur këtë rast për një kohë të gjatë, dëshmojnë se sa e rëndësishme ishte ofrimi i shërbimeve dhe mbrojtjes ligjore falas, nga avokatet e QNL-së në kuadrin e projektit: "Forcimi i grave të dhunuara dhe vulnerable me edukim ligjor, ndihmë ligjore falas dhe advokaci". Ky projekt, pjesë e programit "Mbrojtja dhe promovimi i të drejtave të grave në Shqipëri", zbatohet nga Rrjeti i Fuqizimit të Gruas në Shqipëri (AWEN) me mbështetjen financiare të Agjencisë Suedeze për Zhvillim e Bashkëpunim (SIDA).